



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR

Nr. 9696 Prot

Shkodër, më 14.06.2022

**VENDIM**  
Nr. 361, datë 14.06.2022

**"Për miratimin e Planit të Detajuar Vendor të njësisë strukturore SH009.UB"**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1 shkronja "b" dhe nenit 23, pika 14, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", nenit 5, pika 1.3, shkronja "b", nenit 13, pika 1, shkronja "dh", si dhe nenit 22, të ligjit nr.107/2014 datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar; nenit 72 të VKM nr. 686, datë 22.11.2017 "Për Miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", i ndryshuar; Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Shkodër, miratuar me vendim Nr.5, datë 16.10.2017 nga Këshilli Kombëtar i Territorit, Dokumentit të Rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Shkodër miratuar me Vendimin Nr.9 të KKT, të datës 28.12.2020, Nismës Nr.112, datë 07.4.2021 për Rishikimin e PDV-së për Njësinë Strukturore SH009.UB, Akt-Përputhshmërisë datë 01.04.2022 të Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit si dhe Raportit Teknik të Drejtorisë së Studimeve, Planifikimit dhe Koordinimit të Investimeve, Bashkia Shkodër "Mbi shqyrtimin për miratim të planit të detajuar vendor të njësisë strukturore SH009.UB",

**VENDOSA:**

1. Miratim e planit të detajuar vendor për njësinë strukturore me Kod SH009.UB e cila kufizohet ndërmjet rrugëve: "Skenderbeu", rr. "At Gjergj Fishta", rr. "Marin Bëçikemi".
2. Ngarkohet Drejtoria e Studimeve, Planifikimit dhe Koordinimit të Investimeve për botimin e dokumentacionit përfundimtar të PDV-së me kod SH009.UB në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit sipas legjislacionit në fuqi.
3. Ngarkohet Drejtoria e Studimeve, Planifikimit dhe Koordinimit të Investimeve dhe Drejtoria e Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit për zbatimin e Planit të Detajuar Vendor.
4. Ky vendim hyn në fuqi me botimin në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit.

**KRYETAR**

**Bardh Spahia**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË  
AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

Tiranë, më 01.04.2022

**AKT PËRPUTHSHMËRIE**  
**TË DOKUMENTIT TË PLANIT TË DETAJUAR VENDOR (PDV)**  
**NJËSIA STRUKTURORE SH009.UB, BASHKIA SHKODËR**

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 9 dhe pikës 3 të nenit 23 të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” i ndryshuar, të VKM Nr. 686, datë 22.11.2017 “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, e ndryshuar, të Vendimit Nr. 5, datë 16.10.2017 të Këshillit Kombëtar të Territorit “Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Shkodër”, të Vendimit Nr. 09, datë 28.12.2020 të Këshillit Kombëtar të Territorit “Për miratimin e Rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor Bashkia Shkodër, të miratuar me Vendimin Nr. 5, datë 16.10.2017 të Këshillit Kombëtar të Territorit”, të normave teknike të planifikimit si dhe të dhënave elektronike bazë, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit,

**KONFIRMOI:**

1. Përputhshmërinë e Dokumenteve të Planit të Detajuar Vendor për njësinë strukturore **SH009.UB**, Bashkia Shkodër, me:
  - i. Dokumentin e Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Shkodër në fuqi;
  - ii. Legjislacionin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, në fuqi;
  - iii. Udhëzimin e AKPT-së për përdorimin e Sistemit E-Planifikimi

**DREJTORE E PËRGJITHSHME**

**Adelina GRECA**

